

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org.Jedinita Org Unit	ARPL	Nr i Prot. Bref Prot Prot.No	1392-2/21
Nr i Faqeve Br. Stranica No.Pages	-09-	Data: Datum: Date	25.01.22
PRISHTINË / A			No.1



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
 Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
 Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	14.01.2022
REFERENC-Ë:	1392/21 - ZSP- 2021
PËR/ZA/TO:	„ARBRI-EB” Sh.p.k Shishman K. Gjakovë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së Naser HAFIZI- Zëvendësues i Udhëheqësit të ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Fatlje BUZA - Zyrtare për cilësinë e Ujërave Sipërfaqësor dhe Nëntoksor
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	VENDIM - LEJE UJORE

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktures, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tekniko-investigativ, me Nr. të protokollit: 1392/21, të parashtruar nga „ARBRI-EB” Sh.p.k. Fsh.Shishman K. Gjakovë, dhe ka vendosur si në Vendim për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

Datë: 10.01.2022

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

**VENDIM**

**APROVOHET** kërkesa e palës „ARBRI- EB” SH.P.K., Shishman, K. Gjakovë, me Nr. prot. 1392/21, për **LEJE UJORE**, për shfrytëzimin e ujërave nëntokësor nga Pusi - basen i hapur për prodhim të betonit, sipas kushteve vijuese:

1. Uji i shfrytëzuar është i përcaktuar nga dokumentacioni investivo - teknik me kapacitet optimal:  $Q= 2,24 \text{ l/sec}$  ( dy pik dyzet e katër litra për sekond); me koordinatat e vendit ku operohet ,  $X= 7443818$ ;  $Y= 4693526$ ;  $Z= 386,48$ .

2. Pala përmes regjistrimit me anën e ujëmatësve, duhet të evidentoj: Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore (m<sup>3</sup>/ditë), dhe sasinë vjetore (m<sup>3</sup>/vit). Për sasinë e shfrytëzuarë pala obligohet që për çdo gjashtë muaj të informoj me shkrim ARPL/MMPHI, nga momenti i marrjes së lejes ujore;
3. Numri serik i ujëmatësit duhet presentuar në ARPL, në afat 15 dite nga pranimi i këtij vendimi dhe në ndrimin e mundshëm të ujëmatësit duhet të njoftohet organi përgjegjës (ARPL).
4. Obligimi për kompensimin e ujit të shfrytëzuar, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPHI, sipas Udhëzimit Administrativ në fuqi, për Strukturën e Pagesave të Ujit;
5. Për këtë pala obligohet të raportoj për perioda kohore të shfrytëzimit, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbi sasinë e shfrytëzuar të ujit të matur përmes Ujëmatësit, ashtu që të plotësohet kushti paraprak;
6. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (Pesë) vite.
7. Leja ujore nuk mund të bartet tek personat e tretë, pa informimin e organit kompetent që e ka lëshuar të njëjtën.
8. Leja Ujore pushon ( anulohet) në rast të mos plotësimit të kushteve të lartcekura.

## Arsyetim

Bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH, Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore është shqyrtuar dokumentacionin i palës për aplikim për Leje ujore – shfrytëzim i ujit nëntokësorë nga Pusi ( Basen i hapur) . Pala kërkesës ia ka bashkangjitur edhe dokumentacionin:

- Certifikata e regjistrimit ARBK – “ARBRI – EB”, sh.p.k; Kontratën mbi qiranë e shfrytëzimit të tokës; Leje per Aktivitetet e Veçanta nga Komisioni Pavarur për Miniera dhe Minerale; Kopja e Planit – agjensionit Katastral e Kosovës; Vendimin për Pëlqimin Mjedisor; Faturat e pagesës për Pëlqim Ujor, Leje Ujore, Licenca për kryerjen e matjeve kadastrale; Situacioni i terrenit; Certifikata e Regjistrimit të Kompanisë Hartuese; Diploma e hartuesit, CD.

Andaj bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, akteve administrative të lëshuara nga organet kompetente, legjislacionit për ujërat për shqyrtimin e aplikacioneve për akte ujore, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Nr.: 1392/21 - ZSP- 2022 Datë: 10.01.2022

Prishtinë

Të dërgohet :

- Palës;
- Zyres së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL;
- Inspektariatit të MMPHI;
- Arkivit të Ministrisë